

1829

70/3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 211, datë 11.10.2019

PËR CAKTIMIN NE DETYRE TË PROKURORIT EDLIRA BAKO

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenin 10 të Ligjit nr.40/2017, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të caktojë prokuroren Edlira Bako në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan.
2. Të njoftohen me këtë vendim prokurorja Edlira Bako, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
ARBËNDOLLAPAJ

ANËTAR
BUJAR SHESH

ANËTAR
VATË STAKA

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
BESHNIK ÇANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 135/1 Prot

Tiranë, më 11.10.2019

PROCESVERBAL

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Sot, më datën 11.10.2019 ditë e premte, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 164 deri në 167 të ligjit Nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë". Këshilli mbledhet në prani të dhjetë anëtarëve, të pranishëm përfaqësues OPDAT dhe FURALIUS, si dhe vëzhgues nga organizata të tjera.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit z.Gent Ibrahim i cili prezantoi rendin e dites.

Z.Gent Ibrahim: Mirëmëngjes të nderuar kolegë! Mirëserdhët në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është data 11.10.2019. Falenderime shkojnë për median dhe të ftuarit të pranishëm në sallë.

Këshilli mbledhet sot me këtë rend dite.

Rendi i Dites:

- Miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve Për Rënditjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.
- Miratimi i Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Kujtim Luli.
- Miratimi i Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Gent Xholi.
- Miratimi i raporteve të verifikimit të pasurisë dhe figurës, për disa kandidatë të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

- Miratimi i listës pjesore të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
- Miratimi i projekt aktit për caktimin në detyrë të prokurores Edlira Bako.
- Miratimi i projekt aktit për caktimin në detyrë të prokurores Pranvera Gruda.
- Miratimi i projekt aktit për caktimin e përkohshëm të prokurorit Gjon Fusha.
- Të ndryshme (diskutime/pyetje/përgjigje)

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës, Miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve Për Rënditjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.

Z.G.Ibrahimi: Relaton mbi metodologjinë që do të zbatohet për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve Për Rënditjen e Kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Punë e kryer nga Grupi I Punes..

Z.Beluri: Merr fjalën pasi Z. Ibrahim u kërkon antarëve nëse ata kanë pyetje, sugjerime apo kundërshtime. Z. Beluri konstaton se kriteri për aftësitë profesionale dhe atyre menaxheriale, të paraqitura në pikën 1 dhe 3, përsëriten dhe në pikën që flet për elementët shtesë. Gjithashtu, sipas Z. Beluri shpreh se ka përsëritje dhe të kriterit mbi trajnimet brenda dhe atyre jashtë shkollës së Magjistraturës. Të njëjtin mendim ka dhe Z. Cani.

Z.G.Ibrahimi: Pasi dëgjon sugjerimet, është dakord që kjo pikë të diskutohet dhe të rishikohet, me qëllim që kandidati të mos vlerësohet dy herë për të njëjtin kriter. E nevojshme që të merret parasysh dhe ti jepet një avantazh kandidatit që vjen nga shkolla e Magjistraturës i cili ka dhe trajnimin vazhdues.

Z.Cani: Të kemi koncepte të qarta mbi platformën e ndjekur dhe përcaktimin e saktë të rolit të metodologjisë. E nevojshme të citohet nëse metodologjia është orientuese apo ka vlerën e një akti që sjell pasoja.

Znj Sciti: Eshtë dakord me Z. Cani.

Z.Sheshi: Sqaron se metodologjia lidhur me pikëzimin, është një dokument orientues për Këshillin. Nuk lë vend për diskutim apo të përbëjë problem emërtimi.

Z. Staka: E nevojshme të rishikohet pikëzimi lidhur me përcaktimin e pikëve për gradën shkencore dhe zotërimit të gjuhëve të huaja. Të merret parasysh hierarkia në rënditjen e pikëzimit. Citon dhe ligjin e MASH për këtë çështje.

Z.Baze: Sugjeron që diskutimet mbi metodologjinë, të ishin zhvilluar paraprakisht dhe në një moment të dytë të mbledhjes Këshilli.

Z. Becl: Këshilli të marrë parasysh që në momentin e vendosjes së kriterëve, metodologjisë të shpjegojë logjikën e funksionimit të saj, por jo të bjerë në përsëritje të kriterëve.

Anëtarët: Kundërshtime ka në lidhje me përcaktimin e vjetërsisë prej 15 vitesh të kandidatit, si kriter vlerësues. Sugjerohet që të hiqet pika nga pika 1.4 kriteri i titullit doktor shkencash dhe të pasqyrohet te pika e elementëve shtesë, vetëm për kandidatët e dalë nga shkolla e Magjistraturës, të pasqyrohet te pika e elementëve shtesë.

Z. Balla: Pyet nëse metodologjia do të botohet apo do të jetë një dokument për Këshillin. Konstaton që ka një dublim te kriteri 1.2 me kriterin 1. 5, në lidhje me punimet akademike.

Z. G.Ibrahimi: Metodologjia është një dokument pune i hartuar nga Këshilli dhe që i shërben i shërben shunangies së subjektivizmit. E nevojshme që antarët ta parashtronin që në fillim, nëse nuk ishin dakord me zbatimin e metodologjisë dhe ti referoheshin vetëm Rregullores, jo në mbledhjen e Këshillit. Thekson se, metodologjia është një dokument ndihmës, baza është Rregullorja. Nuk ka vlerë juridike, metodologjia është orientues. Mund të vihet në zbatim nëpërmjet një Udhëzimi.

Z. Baze: Nuk është dakord me kryetarin, pasi sipas tij nëse metodologjia pasi miratohet duhet të zbatohet. Sugjeron që metodologjia të jetë në formën e një Udhëzimi, pasi miratimi i saj, mund të çojë në ndonjë pakënaqësi në radhët e kandidatëve.

Z. Sheshi: Të miratohet metodologjia, pasi çdo pikë e saj nuk bie ndesh me Rregulloren e Këshillit. E nevojshme të hiqen vetëm përsëritjet, sepse pjesa tjetër është në rregull dhe nuk ka nevojë për ndryshime. E panevojshme që Këshilli të dalë me ndonjë akt apo udhëzim.

Z. G.Ibrahimi: Sugjeron që metodologjia të marrë formën e një udhëzimi me ndryshimet e bëra.

Znj. Cimi: Rikujton Rregulloren e Këshillit (Neni 21, paragrafi 3).

Znj. Sciti: Nuk është e domosdoshme që metodologjia të ketë formën e një akti që të sjellë pasoja juridike.

Z. Balla: Është e nevojshme zbatimin e metodologjisë dhe miratimi i saj si një akt i brendshëm në punën e Këshillit. Nuk ka asnjë problem juridik apo procedural.

Z. Dollapa: Sugjeron që diskutimet, sugjerimet apo vërejtjet, duhet të diskutohen në një mbledhje tjetër.

Z. G.Ibrahimi: E nevojshme që Këshilli të reflektojë dhe ta përmirësojë metodologjinë, me qëllim shunangien e përplasjeve. Propozon që akti të tërhiqet për korrigjimet e duhura. Këshilli të dalë në një akt në formën e Udhëzimit dhe të sillet në mbledhjen e radhës.

Në lidhje me Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Kujtim Luli:

Z. Beluri: Relaton në mënyrë të përmbledhur, raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Kujtim Luli, i cili i është vënë në dispozicion antarëve të Këshillit në rrugë elektronike. Në përfundim, fton antarët e Këshillit për miratim.

Z.G.Ibrahimi hodh ne votim

Miratohet me 9 vota pro, në mungesë të Znj. Sciti.

Në lidhje me Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Genti Xholi:

Z. Beluri: Relaton raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokuror Genti Xholi. Edhe ky raport i është vënë në dispozicion antarëve të Këshillit në rrugë elektronike. Në përfundim, fton antarët e Këshillit për miratim.

Z.G.Ibrahimi hedh ne votim
Miratohet me 10 vota pro.

Në lidhje me miratimin e raportit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, për disa kandidatë të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës:

Z. Beluri: Relaton në mënyrë të përmbledhur raportin për 12 kandidatët për magjistrat dhe prokuror për Shkollën e Magjistraturës, në proces verifikimi janë dhe 7 kandidatët e tjerë.

Z. Baze: Pyet për mënyrën e kryerjes së raportit.

Z.G.Ibrahimi: Raporti është kryer në bazë të ligjit, jo të Rregullores, pasi ajo ende nuk është miratuar.

Z.G.Ibrahimi hedh ne votim
Miratohet me 10 vota pro.

Në lidhje me miratimin e listës pjesore të kandidatëve disa kandidatë të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës:

Z.G.Ibrahimi hedh ne votim miratimin e listës pjesore prej 12 kandidatë.
Miratohet me 10 vota pro.

Në lidhje me miratimin e projekt aktit për rikthimin në sistemin e prokurorisë dhe caktimin në detyrë të prokurores Edlira Bako (Duraj) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan:

Z. Ibrahimi shprehet se rasti i znj. Bako, është ai i një prokuroreje, e cila për një kohë të gjatë ka shërbyer në institucione jashtë sistemit përmes procedurës së komandimit. Tashmë znj. Bako ka shprehur dëshirën që të kthehet në sistem. Rasti i saj është shqyrtuar në Komisionin e Karrierës, i cili do raportojë në lidhje me qëndrimin e tij për këtë çështje. Fton z. Dollapaj që të raportojë.

Z. Dollapaj: Relaton rrethanat e faktit për Znj. Bako. Shprehet se Komisioni e ka shqyrtuar kërkesën e znj. Bako, dhe në emër të Komisionit të Karrierës i propozon Këshillit pranimin e kërkesës së Znj. Bako, për tu rikthyer në system si dhe propozon caktimin e përkohshëm pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Nga ana e Komisionit, janë vlerësuar disa momente në lidhje me zbatimin e ligjit, që kjo prokurorë, e cila ka mbajtur postin e Drejtoreshës së Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore pranë Ministrisë së Drejtësisë, të kthehet në vendin e saj të mëparshëm. Është mbajtur parasysh që kjo prokurorë ka qënë më parë e komanduar dhe sipas ligjit pas periudhës së komandimit, ajo duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm. Kjo magjistrate ka një periudhë të gjatë që është shkëputur nga detyra, dhe nga ana e Prokurorisë nuk është respektuar detyrimi për ta kthyer atë në sistem. Janë vlerësuar të gjithë elementët, dhe duke mbajtur parasysh edhe nevojën e sistemit të drejtësisë për prokurorë, dhe është menduar që të kthehet në sistem duke ushtruar detyrën pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Elbasan.

Z. Ibrahim: Ligji të cilin aplikojnë sot, parashikon një afat, dhe njeh statusin e atyre prokurorëve që janë larguar nga sistemi edhe para shumë vitesh. Në këto kushte, propozimi i Komisionit të Karrierës, është i qartë, pra të rikthehet në sistem znj. Edlira Bako dhe të caktohet përkohësisht si prokurorë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Elbasan.

Z.Cani: Propozon që Znj. Bako të rikthehet në sistem dhe jo të caktohet emërim të përkohshëm.

Z. Beluri: Ky është një problem edhe financiar, pasi nëse nuk ka një emërim sjell probleme dhe me trajtimin financiar.

Z.Balla: Ë rëndësishme është që znj. Bako të rikthehet në sistem, por gjithashtu propozon që të caktohet pranë një prokurorie.

Znj. Seiti: Është e nevojshme ti jepet fund procesit për këtë prokurorë. Është kundër caktimit për emërimin e përkohshëm, pasi jepet përshtypja që nuk po e fusim në sistem. Ajo nuk e ka humbur statusin, ne duhet ta emërojmë menjëherë dhe nuk duhet të bëjmë caktim të përkohshëm. Ka mendimin që e njëjta procedurë duhet të ndiqet dhe për Znj. Gruda.

Z. Baze: Mendon se znj. Bako ka mjaft eksperiencë dhe duhet caktuar në Tiranë, pasi njerëz të tillë i duhen sistemit.

Z. Dollapi: Vlerësimi i situatës administrative ka qënë mjaft i vështirë edhe për Komisionin e Karrierës. Në mënyrë konsistente, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk është marrë në konsideratë rikthimi në sistem, prandaj ka qënë e vështirë që të arrihej në këtë propozim. Këtu nuk jemi për të vlerësuar relativitetin e Komisionit, por për të vlerësuar kushtet administrative. Komisioni propozoi që të caktohet në Elbasan dhe në Durrës, për shkak që të mos mbyllin të gjitha pozicionet në Prokurorinë e Tiranës, sepse shumë shpejt do të fillojë procesi i hartimeve të rregulloreve për transferimet paralele dhe ngritjet në detyrë, dhe prandaj nuk duhet të ketë caktim të përhershëm, dhe të njëjtën gjë mendon edhe për rastin e znj. Pranvera Gruda.

Z. Balla: Komisioni e ka patur të vështirë të arrijë në përfundime në lidhje me caktimin e emërimit për Znj. Bako dhe Znj. Gruda, pasi në vlerësimin e Komisionit të Karrierës, është ende herët për lëvizjet paralele pranë prokurorive në Tiranë. Komisioni vlerëson se, ato duhet të kenë njëfarë eksperience, ndaj Z. Balla e mirëkupton vendimin e këtij komisioni, edhe pse si Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe ajo e Elbasanit, janë gjykata karriere. Të dyja magjistratet kanë nevojë për pak kohë sa të rimarrin veten dhe të rihyjnë në pozicionet me rëndësi, siç është dhe prokuroria e Tiranës.

Z. Beçi: Në këtë seancë duhet të shprehemi për pranimin e kërkesës për rikthimin në sistem, dhe në mbledhjen e ardhshme të paraqesin dhe propozimin se ku duhet të caktohen.

Z.G.Ibrahimi hedh në votim propozimin e Komisionit të Karrierës, për rikthimin në sistem të prokurores Edlira Bako dhe caktimin e përkohshëm të saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Elbasan.

Miratohet me 10 vota pro.

Në lidhje me miratimin e projekt aktit për caktimin në detyrë të prokurores Pranvera Gruda:

Z.G.Ibrahimi: Znj. Gruda ka shërbyer shpesh herë në pozicione të komanduara, duke kapërcyer dhe afatet që përcakton ligji. Rasti është i ngjashëm me atë të znj. Bako. Edhe znj. Gruda kërkon rikthimin në sistemin e prokurorisë dhe caktimin në një pozicion.

Z. Dollapi: Relaton rrethanat e faktit dhe punën e bërë nga Komisioni për Znj. Gruda. Shprehet se në relacion janë shpjeguar të gjitha rrethanat, dhe janë mbajtur parasysh të gjitha kriteret dhe kërkesat e saj për rikthimin në sistem. Sipas kërkesës së saj, Komisioni i Karrierës, propozon rikthimin në sistem të znj. Gruda, me detyrë aktualisht në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe caktimin e Znj. Gruda si prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ajo ka pasur një eksperiencë të gjatë. Ka qënë prokurore Apeli në prokurorinë e Shkodrës. Duke qënë se nuk ka vende vakante pranë kësaj prokurorie, është vlerësuar që të caktohet si prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së parë Durrës.

Z. Beluri: Pozicioni në të cilin ka shërbyer znj. Gruda, pra si ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, nuk është një ndër ato pozicionet ku mund të komandohet një prokuror dhe mund të ruhet statusi.

Z. Staka: Me hyrjen e ligjit të ri, mund të shihet ndryshe. Znj. Gruda ka bërë disa kërkesa, që nga data 15.01.2019 dhe deri në 18.01.2013 që është dhe kërkesa e saj e fundit, që të rikthehet në detyrën e prokurores.

Z. Ibrahimi: shtron pyetjen nëse pozicioni si ndihmëse ligjore, është një ndër ato pozicione ku mund të komandohet një prokuror.

Z. Staka citon bazën ligjore ku argumenton që ky komandim është bërë në një institucion në përputhje me ligjin.

Znj. Selti: argumenton se për sa kohë znj. Gruda dhe znj. Bako, po trajtohen me ligjin e vjetër që nuk ka afat, atëherë nuk ka rëndësi se ku kanë punuar. Statusi i tyre ka vazhduar të jetë i pandërprerë. Në këtë seancë, ato marrin edhe statusin edhe emërimin.

Z. Beluri: me ligj, këto duhet të përfitojnë statusin e prokurorit për të gjithë periudhën që i është shtyrë, dhe duhet të marrin vjetërsinë si prokuror.

Z.G.Ibrahimi shtron për diskutim përsëri, që nëse pozicioni në të cilin ka vajtur znj. Gruda, ka qënë një ndër pozicionet ku mund të komandohej një prokuror. Nëse është kështu, atëherë znj. Gruda vazhdon ta ketë statusin. Nëse jo, atëherë znj. Gruda i është ndërprerë statusi.

Z. Beci: Prokurores i është bërë edhe vlerësimi etiko profesional, si të gjithë prokurorëve të tjerë. Kështu që ajo është trajtuar me statusin e prokurorit.

Z.G.Ibrahimi hedh në votim propozimin e Komisionit të Karrierës, për rikthimin në sistem të prokurores Pranvera Gruda dhe caktimin e përkohshëm të saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës.

Miratohet me 9 vota pro. Kundër z. Beluri

Në lidhje me miratimin e projekt aktit për caktimin e përkohshëm të prokurorit Gjon Fusha:

Z. Beci: Relaton rrethanat e faktit për Z. Fusha, i cili e ka përfunduar afatin 3 mujor të emërimit te përkohshëm.

Z.G.Ibrahimi hedh ne votim
Miratohet me 10 vota pro.

Në lidhje me miratimin e projekt buxhetit të Këshillit të Lartë Të Prokurorisë:

Z.G.Ibrahimi: Fton Sekretaren e Përgjithshme, Znj. Iliriana Nano për disa sqarime lidhur me këtë projekt buxhet. Znj. Nano shprehet se për këtë projekt buxhet, është ndjekur modeli i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas këtij projekt buxheti, antarëve të Këshillit kanë të drejtë të përfitojnë në masën prej 150 litra karburant, që do tu shërbejë atyre për të përmbushur më së miri detyrat që burojnë nga angazhimi i tyre në këtë organ. I lihet detyrë Sekretarit të Përgjithshëm të shohë hapësirat ligjore mbi shtrirjen dhe efektet e këtij projekt buxheti. Këshilli është në pritje të ofertave, për sa i përket prokurimit të automjeteve dhe më shpresën e mundësisë së pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Z.G.Ibrahimi deklaron të mbyllur seancën.

KRYETARI

GENT I BRAHIMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

RELACION

NË LIDHJE ME KËRKESËN NR.211 PROT., DT 26.02.2019 TË ZNJ.EDLIRA BAKO
PËR RIKTHIMIN NË DETYRË

I. RRETIANAT E FAKTIT

Me datë 26.02.2019 është paraqitur në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kërkesa e Znj. Edlira Bako (Duraj) me objekt rikthimin në detyrën e prokurores.

Kërkesja është emëruar zëvendësprokurore në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 13.02.1996 dhe ka ushtruar këtë detyrë për një periudhë 7 vjeçare deri në vitin 2003.

Me datë 04.02.2003, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, ajo është emëruar Inspektore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë, dhe aktualisht mban detyrën e Drejtoreshës së Drejtorisë Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.

Në Janar 2013, Qershor 2014, Nëntor 2016 dhe Mars 2018 ka kërkuar rikthimi në detyrën e prokurores sipas vendeve vakante të shpallura nga Prokuroria e Përgjithshme në vitet përkatëse.

Me kërkesën nr. 211 prot, datë 26.02.2019, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Znj. Edlira Bako (Duraj) kërkon përfundimin e periudhës së punësimit/komandimit ne Ministrinë e Drejtësisë dhe rikthimin në detyrën e prokurores.

II. BAZA LIGJORE

- a. Ligj Nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"

Neu 44

Punësimi si nëpunës civil

1. Prokurori mund të punojë në nivele drejtuese dhe ekzekutuese të kabinetit të Ministrit dhe të strukturave juridiko - profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e punësimit të tyre në këto struktura njihet si periudhë vjetërsie në punë si prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale.

2. Prokurorët që punojnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesën e tyre rrimërohen pa konkurs prokurorë.

- b. Ligj Nr.10 051, datë 29.12.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

Neni 22

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

Neni 44

Ruajtja e statusit të prokurorit

1. Prokurorët, me kërkesën e institucioneve dhe me pëlqimin e tyre, mund të shërbejnë për një afat deri në katër vjet në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, të Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në mbarim të këtij afati, me kërkesën e tyre, ata rrimërohen prokurorë, pa konkurs, në vendin që kanë pasur.
2. Trajtimi financiar i prokurorit bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.
3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si prokuror, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6009, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

- c. Ligj Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

KREU VI KOMANDIMI

Neni 57

Përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit

1. Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar.
2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara.
3. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli e konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose në procedurat e ngritjes në detyrë.

4. Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj.

....

- d. Ligj nr. 40/2017 Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar

Neni 10

Dispozita kalimtare

Gjyqtarët dhe prokurorët që ushtronin funksione në nivelet drejtuese dhe ekzekutive në Ministrinë e Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konsiderohen magjistratë të komanduar dhe trajtohen sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

III. ARSYETIMI

Nga kërkesa e depozituar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë rezulton se kërkuesja Edlira Bako (Duraj) është emëruar zëvendësprokurore në vitin 1996 dhe e ka ushtruar këtë detyrë deri në vitin 2003.

Në vitin 2003, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, kërkuesja është emëruar në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, ku ka shërbyer fillimisht si inspektore e sektorit të prokurorisë, përgjegjëse sektori e aktualisht si drejtoreshë në Drejtorinë Rregullatore për Çeshtjet e Drejtësisë.

Ligji Nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" nuk përcaktonte kufizim kohor për periudhën e shërbimit të prokurorëve në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë.

Më tej, me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në dispozitën e titulluar "Ruanjtja e statusit të prokurorit" u përcaktua se prokurorët mund të shërbejnë në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, të Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës për një afat deri në katër vjet. Ky ndryshim ligjor që hyri në fuqi në janar të 2009, përcaktoi një kufizim kohor për periudhën e shërbimit në këto struktura për të gjithë prokurorët e komanduar të cilët donin të vazhdonin të ruanin statusin.

Duke marrë parasysh këtë parashikim, nëse do konsiderojmë se llogaritja e afateve fillon nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij rregullimi (Janar 2009), rezulton se komandimi i kërkueses Edlira Bako (Duraj) do kishte si afat maksimal janarin 2013.

Ligji i kohës parashikonte që *“Në mbarim të këtij afati, me kërkesën e tyre, ata rrimërohen prokurorë, pa konkurs, në vendin që kanë pasur.”* Pra, rikthimi në vendin e mëparshëm nuk kryhej automatikisht me mbarimin e afatit, por ishte një proces që vihej në lëvizje nga kërkesa e prokurorit, të cilit i kishte përfunduar afati i komandimit në institucionin përkatës.

Kërkuesja sqaron se ka kërkuar disa herë rikthimin në detyrën e prokurorit, por diçka e tillë nuk i është mundur. Nga verifikimet e kryera pranë Zyrës së Burimeve Njerzore në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton që ajo ka ndërmarrë veprime konkrete që nga Janari i vitit 2013 e në vazhdim, Qershor 2014, Nëntor 2016 dhe Mars 2018, ka paraqitur kërkesa për kryerjen e veprimit administrativ nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, për riktimin e saj në detyrën e prokurorit.

Po kështu dispozitat tranzitore të Ligjit nr. 40/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”*, të ndryshuar, ku parashikohet se *gjqtarët dhe prokurorët që ushtronin funksione në nivelet drejtuese dhe ekzekutive në Ministrinë e Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, konsiderohen magjistratë të komanduar dhe trajtohen sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vlen të theksohet se ky ligj për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë në mënyrë specifike ka parashikuar që këta punonjës konsiderohen magjistratë të komanduar.

Në këto kushte në referencë dhe të dispozitës kalimtare të Ligjit nr.40/2017, kërkuesja Edlira Bako (Duraj), nga Komisioni Për Zhvillimin e Karrierës vlerësohet se duhet të caktohet si prokurore në një prokurori të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Meqenëse Prokuroria e Tepelenës, ku ajo ka ushtruar detyrën e prokurores, nuk ekziston më, Komisioni propozon caktimin e kësaj prokuroreje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

KOMISIONI PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS